

## Organizata për siguri dhe bashkëpunim në Evropë MISIONI NË KOSOVË

### Raporti 04/2006 i Shtyllës së III-të (OSBE) mbi monitorimin e Kuvendit të Kosovës 20 maj 2006 – 30 qershor 2006

#### Titujt kryesor

- Kuvendi miraton reforma me qëllim të përmirësimit të efikasitetit të tij dhe forcimit të mbikqyrjes së Qeverisë, duke përfshirë disa ndryshime të Rregullorës për punën e Kuvendit
- Me miratimin e reformave, Kuvendi fillon të mbajë sesione të rregullta për pyetjet dhe përgjigjet e Qeverisë
- Deputetët e PDK-së dorëzojnë mocionin lidhur me Ligjin për të drejtat dhe statusin e familjeve të dëshmorëve, invalidëve, veteranëve dhe pjesëtarëve të UÇK-së, dhe viktimave civile të luftës<sup>1</sup>, ndërsa ata të LDK-së mocionin lidhur me mihjen e jashtëligjshme të zhavorit
- Pas disa muajsh vonese, anëtarët e Grupit për Integrim përfshihen më në fund në komisionet funksionale të Kuvendit
- Kuvendi kërkon nga UNMIK-u sqarim lidhur me procedurën për emërimin e zëvendësministrave

#### 1. Sfond

Raporti i dyzetekatërt i monitorimit është hartuar në përputhje me pikëpamjet referuese të Shtyllës së III-të të UNMIK-ut për themelimin e institucioneve (OSBE) dhe monitorimin e Kuvendit të Kosovës prej 26 nëntor 2002 dhe bazohet në pajtueshmërinë me Rregulloren e re të punës të miratuar në fund të seancës plenare më 20 maj 2005, dhe të amendamentuar në seancën plenare të mbajtur më 1-2 qershor 2006 (shiko “Miratimi i ndryshimeve në Rregulloren e Punës së Kuvendit”).<sup>2</sup>

Gjatë periudhës raportuese, Kuvendi ka mbajtur tri seanca plenare të rregullta, më 1-2 mars, 15 qershor dhe më 29 qershor, si dhe pesë mbledhje të rregullta të Kryesisë, më 25 maj, 29 maj, 12 qershor, 23 qershor, dhe 26 qershor. Të dhjetë komisionet, si dhe nënkomisioni për të drejtat e njeriut, barazi gjinore, peticione dhe ankesa publike, i kanë mbajtur mbledhjet gjatë kësaj periudhe.<sup>3</sup>

<sup>1</sup> Sipas rregullores së UNMIK-ut 2006/29, emri zyrtar është “Ligji për statusin dhe të drejtat e familjeve të dëshmorëve, invalidëve, veteranëve dhe anëtarëve të UÇK-së dhe familjeve të viktimave civile të konfliktit të armatosur në Kosovë”. Me qëllim të thjeshtësimit, dhe për shkak se përshkrimi reflekton diskutimin që është bërë në Kuvend, ky raport do t’i referohet këtij ligji si Ligji për të drejtat dhe statusin e familjeve të dëshmorëve, invalidëve, veteranëve dhe pjesëtarëve të UÇK-së, dhe viktimave civile të luftës.

<sup>2</sup> Amendamentet ishin miratuar në fillim të seancës plenare të 1-2 qershorit andaj ende nuk kishin hyrë në fuqi deri në atë moment.

<sup>3</sup> Komisioni për çështje gjyqësore, legjislativ dhe Kornizë Kushtetuese është takuar më 29 maj dhe 12, 14, 19 dhe 26 qershor derisa Komisioni për shërbime publike, administratë lokale dhe media është takuar më 6 qershor. Komisioni për buxhet dhe financa është takuar më 25 maj dhe 7, 14 e 28 qershor derisa komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve është takuar më 29 maj 5 dhe 12 qershor. Komisioni për shëndetësi, punë, mirëqenie sociale dhe persona të zhdukur është takuar më 30, 31 maj dhe 6, 13, 20 dhe 27 qershor derisa Komisioni për arsim, shkencë, teknologji, kulturë, rini dhe sport është takuar më 24 maj dhe 26 qershor. Komisioni për bashkëpunim ndërkombëtar dhe integritet euroatlantike është takuar më 14 qershor derisa Komisioni për gatishmëri emergjente është takuar më 29 maj, dhe 8 e 27 qershor. Komisioni për bujqësi, pylltari, zhvillim rural, ambient dhe planifikim hapësinor është takuar më 23 maj dhe 27 qershor derisa Komisioni për ekonomi, tregti, industri, energji, transport dhe telekomunikacion është takuar më 22, 30 maj dhe 6 e 19 qershor. Nënkomisioni për të drejtat e njeriut, barazi gjinore dhe peticione e ankesa publike është

Shtylla e III-të (OSBE) i ka monitoruar seancat plenare dhe mbledhjet e Kryesisë, si dhe 31 prej 33 mbledhjeve të komisioneve dhe tri dëgjime publike.<sup>4</sup>

## 2. Vështrim

**Seancën plenare të Kuvendit të Kosovës të mbajtur më 1-2 qershor** e kryesoi Kryetari i Kuvendit Kolë Berisha (LDK) dhe bashkëkryesoi anëtari i Kryesisë z. Xhavit Haliti (PDK).

- Shtatëdhjetë e gjashtë dhe 71 deputetë ishin të pranishëm në seancën plenare më 1, përkatësisht 2 qershor.<sup>5</sup>
- Pikat kryesore të rendit të ditës të seancës plenare të 1-2 qershorit:
  - Propozimi i reformave për përmirësimin e funksionimit të Kuvendit dhe disa ndryshimeve relevante në Rregulloren e punës së Kuvendit (Ndryshimet e propozuara në Rregulloren e punës janë miratuar me 74 vota për dhe dy vota kundër. Shiko “Miratimi i ndryshimeve në Rregulloren e punës.”)
  - Shqyrtimi i dytë i projektligjit për Operën, Baletin dhe Filharmoninë e Kosovës (Projektligji është miratuar me 57 vota për dhe dy vota kundër.)
  - Shqyrtimi i dytë i projektligjit për mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera (Projektligji është miratuar me 62 vota për dhe dy vota kundër.)
  - Shqyrtimi i parë i projektligjit për amandamentimin e ligjit për arkivat (Projektligji është miratuar në parim me 66 vota për dhe një votë kundër.)
  - Shqyrtimi i parë i projektligjit për nxitjen, promovimin dhe mbrojtjen dhe e të ushqyerit me qumësht gjiri (Projektligji është miratuar në parim me 61 vota për dhe nëntë vota kundër.)
  - Shqyrtimi i parë i projektligjit për hulumtimet gjeologjike (Projektligji është miratuar në parim me 72 vota për dhe një votë kundër.)
  - Miratimi i nominimit të z. Altay Suroy për zëvendësministër të Drejtësisë (Kjo pikë e rendit të ditës është shtyrë. Shiko “Emërimi i zëvendësministrave”.)
  - Propozimi për shtimin e numrit të anëtarëve në komisionet funksionale (Propozimi është miratuar me 68 vota për dhe gjashtë vota kundër. Shiko “Emërimi i anëtarëve të ri në komisione”.)
  - Shqyrtimi i raportit të buxhetit të Kosovës për vitin 2005 (Raporti është miratuar me 52 vota për dhe 21 vota kundër.)

**Seancën plenare të Kuvendit të Kosovës të mbajtur më 15 qershor** e kryesoi Kryetari i Kuvendit Kolë Berisha (LDK) dhe bashkëkryesoi anëtari i Kryesisë z. Sabri Hamiti (LDK).

---

takuar më 14 dhe 28 qershor. Komisioni për shëndetësi, punë, mirëqenie sociale dhe persona të zhdukur ka mbajtur dëgjimin publik të projektligjit për ndërprerjen e shtatzënisë më 24 maj. Komisioni për buxhet dhe financa ka mbajtur një dëgjim publik të projektligjit për parandalimin e pastrimit të parave më 13 qershor. Komisioni për ekonomi, tregti, industri, energji, transport dhe telekomunikacion ka mbajtur një dëgjim publik të projektligjit për hulumtimet gjeologjike në Kosovë më 19 qershor.

<sup>4</sup> Komisioni për çështje gjyqësore, legjislative dhe Kornizë Kushtetuese më 29 maj dhe 12, 14, 19 dhe 26 qershor; Komisioni për shërbime publike, administratë lokale dhe media më 6 qershor; Komisioni për buxhet dhe financa më 25 maj dhe 7, 14 dhe 28 qershor; Komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe kthim më 29 maj dhe 5 e 12 qershor; Komisioni për shëndetësi, punë, mirëqenie sociale dhe persona të zhdukur më 30, 31 maj dhe 6, 13, 20 dhe 27 qershor; Komisioni për arsim, shkencë, teknologji, kulturë, rini dhe sport më 24 maj dhe 26 qershor; Komisioni për gatishmëri emergjente më 29 maj dhe 8 e 27 qershor; Komisioni për bujqësi, pylltari, zhvillim rural, ambient dhe planifikim hapësinor më 23 maj; Komisioni për ekonomi, tregti, industri, energji, transport dhe telekomunikacion më 22, 30 maj dhe 6 e 19 qershor; Komisioni për bashkëpunim ndërkombëtar dhe integrim Euro-Atlantik më 14 qershor; nënkomisioni për të drejtat e njeriut, barazi gjinore dhe peticione e ankesa publike më 28 qershor; Dëgjimin publik të projektligjit për ndërprerjen e shtatzënisë më 24 maj; Dëgjimin publik të projektligjit për parandalimin e pastrimit të parave më 13 qershor; Dëgjimin publik të projektligjit për hulumtimet gjeologjike në Kosovë më 19 qershor.

<sup>5</sup> Kjo ishte shifra e dhënë nga Kryetari i Kuvendit ose Kryesuesi në fillim të asaj dite, përveç nëse në këtë raport është bërë e ditur në ndonjë mënyrë tjetër. Numri i deputetëve të pranishëm ndryshonte gjatë ditës; për shembull, në një moment gjatë seancës më 1 qershor ishin të pranishëm të paktën nëntëdhjetë deputetë.

- Shtatëdhjetë e tre deputetë ishin të pranishëm në seancën plenare të 15 qershorit.
- Pikat kryesore të rendit të ditës të seancës plenare të 15 qershorit:
  - Shqyrtimi i dytë i projektligjit kundër shpifjes dhe fyerjes (Projektligji është miratuar me 63 vota për, një votë kundër, dhe një abstenim.)
  - Shqyrtimi i dytë i projektligjit për veprimtaritë hidro-meteorologjike (Projektligji është miratuar me 67 vota për dhe një votë kundër.)
  - Shqyrtimi i dytë i projektligjit për efikasitetin e energjisë (Kuvendi ka vendosur, me 45 vota për, 25 vota kundër dhe tre abstenime, që ta shtyejë shqyrtimin e dytë të projektligjit me qëllim të mundësimit të konsultimeve të mëtejshme me Qeverinë.)
  - Shqyrtimi i parë i projektligjit për amendamentimin e ligjit për standardizim (Projektligji është miratuar në parim me 58 vota për dhe një votë kundër. Shiko pikën e parë nën “Procesi i votimit”.)
  - Shqyrtimi i parë i projektligjit për raportimin financiar të ndërmarrjeve (Projektligji është miratuar në parim me 68 vota për dhe dy vota kundër.)
  - Përgjigja e Kryeministrit në interpelancën lidhur me Ligjin për të drejtat dhe statusin e familjeve të dëshmorëve, invalidëve, veteranëve dhe pjesëtarëve të UÇK-së, dhe viktimave civile të luftës (Shiko “Interpelanca”.)
  - Shqyrtimi i propozimit për miratimin e anëtarit të pestë të këshillit të Komisionit të Pavarur për Media (KPM) (Kjo pikë është hequr nga rendi i ditës. Shiko pikën e parë nën “Rendi i ditës”.)
  - Shqyrtimi i propozimit për procedurën e zgjedhjes së Ombudspersonit të Kosovës (Propozimi është miratuar me 68 vota për dhe pesë vota kundër.)
  - Pyetjet për Qeverinë

**Seancën plenare të Kuvendit të Kosovës të mbajtur më 29 qershor** e kryesoi Kryetari i Kuvendit Kolë Berisha (LDK) dhe bashkëkryesoi anëtari i Kryesisë z. Gazmend Muhaxheri (ORA).

- Shtatëdhjetë e nëntë deputetë ishin të pranishëm në seancën plenare të 29 qershorit.
- Pikat kryesore të rendit të ditës të seancës plenare të 29 qershorit:
  - Fjala lamtumirëse e PSSP-së Jessen-Petersen në Kuvend
  - Pyetjet për Qeverinë
  - Shqyrtimi i parë i projektligjit për peshkatari dhe akuakulturë (Projektligji është miratuar në parim me 63 vota për dhe një votë kundër.)
  - Shqyrtimi i parë i projektligjit për prokurimin publik në Kosovë (Kuvendi ka vendosur, me 44 vota për dhe 13 vota kundër, që ta kthejë projektligjin në Qeveri me udhëzimin se duhet të kthehet në formë të amendamenteve në ligjin ekzistues.)
  - Shqyrtimi i dytë i projektligjit për botimin e teksteve shkollore, mjeteve mësimore, lektyrës shkollore dhe dokumentacionit pedagogjik (Projektligji është miratuar me 66 vota për dhe pa vota kundër.)
  - Shqyrtimi i raportit lidhur me vërejtjet e zyrës ligjore të UNMIK-ut në Ligjin për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta (2004/45), të miratuar më 27 shtator 2004 (Kuvendi i miratoi amendamentet e propozuara në këtë ligj me 58 vota për dhe pa vota kundër.)
  - Shqyrtimi i raportit vjetor 2005 të Komisionit Rregullativ për Prokurim Publik (Kuvendi, me disa kritika, e miratoi raportin me 45 vota për dhe 16 vota kundër.)
  - Interpelanca e Ministrit për Mjedis dhe Planifikim Hapësinor Ardian Gjini me kërkesë të deputetit të Kuvendit Naser Osmani dhe dhjetë deputetëve të LDK-së
  - Miratimi i emërimeve të reja nga LDK-ja, PDK-ja dhe Grupi për Integrim në komisionet funksionale të Kuvendit

(Kjo pikë është përfshirë në rendin e ditës në fillim të seancës. Emërimet janë miratuar *en bloc* me 55 vota për dhe pesë vota kundër.)

### 3. Punimet dhe praktikat parlamentare në seancat e Kuvendit

#### Miratimi i ndryshimeve në Rregulloren e punës

- Në fillim të seancës plenare të 1-2 qershorit, pas miratimit të rendit të ditës, Kryetari i Kuvendit u rikujtoi deputetëve se me rastin e zgjedhjes për Kryetar, ai publikisht kishte vendosur që Kuvendin ta bënte më demokratik dhe ta ndihmonte në përafrimin me standardet parlamentare të vendeve më të përparuara. Ai më pas e paraqiti planin gjithëpërfshirës për reformim që ishte hartuar për Kuvendin, i cili përfshin kalendarin për pjesën e mbetur të vitit 2006 me datat e seancave plenare dy-tri herë në muaj dhe mbledhjet e rregullta me shefat e grupeve parlamentare dhe kryesuesit e komisioneve, si dhe plani i standardeve për Kuvendin, i cili përmban dispozita për periudhë të rregullt të pyetjeve për qeverinë, interpelanca të rregullta, mbështetje teknike për komisionet, nisma për draft buxhetin nga komisioni për buxhet dhe që miratohet nga Kryesia, dhe çasja në dokumentet publike. Kryetari i Kuvendit theksoi se shumica e këtyre reformave mund të bëhen brenda kornizës ekzistuese të rregullores së punës por një numër i kufizuar i dispozitave siç janë ato që rregullojnë miratimin e rendeve të ditës së seancave plenare, pyetjet për Qeverinë, dhe interpelancat, do të duhej të ndryshohen. Grupet parlamentare të LDK-së, PDK-së, AAK-së, ORA-s, 6+, dhe Grupi për Integrim u shprehën në mbështetje të reformave duke deklaruar se reformat do ta bënin punën e Kuvendit më efikase dhe do ta forconin mbikëqyrjen e Kuvendit mbi Qeverinë. Z. Gani Koci (PDK) kundërshtoi për faktin se ndryshimet e propozuara në rregulloren e punës nuk ishin shqyrtuar së pari në komisionin ad-hoc për rregulloren e punës, dhe deklaroi se në parim i mbështeste ndryshimet por besonte se edhe disa ndryshime shtesë në rregulloren e punës duhej të shqyrtohen. Kryetari i Kuvendit u përgjigj se secili deputet e ka të drejtën të propozojë amendamente në rregulloren e punës dhe vazhdoi duke thirrur Kuvendin që t'i votonte secilën nga katër ndryshimet e propozuara veç e veç. Pas miratimit të secilit ndryshim të propozuar, ai e ftoi Kuvendin ta votonte propozimin në tërësi, i cili është miratuar me 74 vota për dhe dy vota kundër.

*Rregulla 3.4 parasheh që Kuvendi në seancën konstituive ose në mbledhjen tjetër të radhës, do ta formojë një komision ad hoc për Rregulloren e punës të Kuvendit. "Komisioni përgatit projektin e rregullores së punës dhe ia paraqet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim. Rregullorja e punës duhet të jetë në pajtim me dispozitat e Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisjen e Përkohshme." Rregullorja nuk parasheh që komisioni duhet të jetë i përfshirë në amandamentimin e mëvonshëm të rregullores së punës. Sipas rregullës 58 "Kryesia e shqyrton vazhdimisht Rregulloren e punës dhe kohë pas kohe mund t'i propozojë Kuvendit ndryshime, që mendon se janë të nevojshme. Kryesisë së Kuvendit mund t'i bëhet propozimi për ndryshimin e Rregullores nga çdo deputet i mbështetur të paktën nga dhjetë (10) deputetë të tjerë. Vendimin për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores së punës, e merr Kuvendi, me shumicë votash të anëtarëve të Kuvendit. Derisa të nxirret një rregullore e re, Kuvendi vepron sipas rregullores së vjetër." Andaj, Rregullorja e punës ishte amandamentuar në pajtim me dispozitat përkatëse të rregullores së punës.*

#### Rendi i ditës

- Kryetari i Kuvendit e paraqiti rendin e ditës të seancës plenare të 1-2 qershorit për miratim në fillim të seancës në fjalë me propozimin për shtimin e dy pikave tjera: zgjerimi i komisioneve funksionale të Kuvendit me nga dy deputetë për secilin komision, dhe paraqitja e reformave të propozuara për përmirësimin e funksionimit të Kuvendit dhe disa ndryshimeve në rregulloren e punës. Rendi i ditës i ndryshuar ishte miratuar me votim formal. Kryesuesi e paraqiti për miratim rendin e ditës të seancës plenare të 15 qershorit në fillim të seancës. Z. Ibush Jonuzi (LDK) kryesues i Komisionit për ekonomi, tregti, industri, energji, transport dhe telekomunikacion, kërkoi që shqyrtimi dytë i projektligjit për efikasitetin e energjisë të shtyhej për të mundësuar më shumë konsultime me Qeverinë. Z. Gani Koci (PDK) në emër të grupit të

tij parlamentar e shprehu kundërshtimin ndaj këtij propozimi para se ai të hudhej në votim. Kuvendi me 45 vota për dhe 25 kundër vendosi që ta shtyej këtë pikë të rendit të ditës. Z. Alush Gashi (LDK) komentoi se Kuvendi nuk kishte marrë kurrfarë informacioni për kandidatin që do të emërohej si anëtar i pestë i Këshillit të KPM-së dhe kërkoi shpjegimin ose shtyerjen e kësaj pike të rendit të ditës. Kryesuesi u përgjigj se Kryesia kishte vendosur ta propozonte kandidatin por në ndërkohë kishte kuptuar se ai mund të kishte konflikt interesash dhe propozoi që miratimi i tij mos të heqej nga rendi i ditës derisa statusi i tij të qartësohej. Z. Fehmi Mujota (PDK) deklaroi se grupi i tij parlamentar e mbështeste deklaratën e z. Gashi, dhe shtoi se anëtari i pestë i këshillit të KPM-së duhet të zgjedhet nga Kuvendi në mënyrë të hapur duke lënë të kuptohet ndër të tjera se informatat biografike duhet të ipen dhe se Kuvendi duhet të konstatoj nëse kandidati i plotëson të gjitha kriteret e parapara mjaft qartë në ligj. Shumica e deputetëve të pranishëm votuan për shtyerjen e kësaj pike të rendit të ditës. Z. Xhavit Haliti (PDK) poashtu komentoi për rëndësinë e këshillit të KPM-së dhe nevojës për t'iu qasur me seriozitet procesit të përzgjedhjes. Z. Jakup Krasniqi (PDK) deklaroi se para disa javësh grupi i tij parlamentar me mbështetjen e së paku dyzet nënshkrimeve kishte kërkuar jo vetëm diskutim për gjendjen në Universitet por diskutim më të përgjithshëm për arsimin në Kosovë. Ai rikujtoi se PDK-së i ishte thënë se arsimit do të debatohej në njërin nga seancat e mëvonshme, por nuk ishte përfshirë në rendin e ditës të asnjërës prej dy seancave plenare pas seancës së 12/15 majit kur ishin diskutuar zhvillimet e fundit në Universitet. Kryesuesi u përgjigj se Kryesia do ta diskutonte këtë çështje.

Kuvendi, në fillim të seancës plenare më 29 qershor ka votuar për ta përfshirë në rendin e ditës miratimin e propozimeve të LDK-së, PDK-së, dhe Grupit për Integrim për caktimin e deputetëve në komisionet funksionale.

*Rregulla e mëparshme 23.1<sup>6</sup> e cila kërkonte që rendi i ditës për cilëndo seancë plenare të propozohet nga një anëtar i Kryesisë dhe të miratohet nga Kuvendi në fund të seancës paraprahe, ishte ende e zbatueshme kur rendi i ditës së seancës plenare të 1-2 qershorit ishte miratuar, meqë katër amendamentet në rregulloren e punës (shiko paragrafin e mëparshëm) ishin miratuar vetëm më pas. Andaj, rendi i ditës nuk është paraqitur në pajtim me rregullat procedurale në fuqi në atë kohë, siç ka ndodhur në disa seanca të mëparshme.<sup>7</sup>*

*Dispozitat përkatëse që ishin miratuar më vonë gjatë asaj dite, të cilat i zëvendësojnë dispozitën e lartpërmendur, janë si vijon: “Kuvendi përgatit rendin e ditës për seancën e radhës dhe ia paraqet menjëherë deputetëve të Kuvendit. Në fillim të seancës rendi i ditës konsiderohet i miratuar përveç nëse një ose më shumë grupe parlamentare apo gjashtë (6) deputetë të Kuvendit i propozojnë Kryetarit të Kuvendit amendamente me shkrim në rendin e ditës, i cili hudhet në votim” (rregullat e reja 23.1-2). Kur ishin miratuar rendet e ditës të seancave plenare të 15 dhe 29 qershorit rregullat në fuqi kërkonin që rendi i ditës të miratohet vetëm në fillim të seancës në fjalë. Andaj, rendi i ditës i seancës plenare më 15 qershor ishte miratuar në pajtim me rregulloren.*

### Mocionet procedurale

- Në fillim të seancës plenare të 15 qershorit, z. Emrush Xhemajli (LPK) propozoi që Kuvendi ta ndërpriste seancën derisa të liroheshin protestuesit e arrestuar të Vetëvendosjes. Gjersa e elaboronte propozimin e tij, iu çkyq mikrofonit. Kryesuesi tha se Kuvendi ishte duke diskutuar për rendin e ditës dhe se deputetët mund të flisnin për rendin e ditës vetëm një minute. Kuvendi vazhdoi me diskutimin e rendit të ditës, mirëpo propozimi i z. Xhemajli nuk është vëre në votim. Z. Hydajet Hyseni (PDK) tha se dëshironte të bënte vërejtje në zbatimin e Rregullores së punës, duke cituar rregullën 30.1(e)<sup>8</sup>, dhe duke pohuar se fjalimet në lidhje me rendin e ditës zgjasin

<sup>6</sup> “Në fund të çdo seance, Kryetari i Kuvendit, ose një anëtar tjetër i Kryesisë, propozon rendin e ditës të seancës së ardhshme. Ky propozim konsiderohet i miratuar, përveç në rastet kur një ose më shumë grupe parlamentare ose ... 6 deputetë e kundërshtojnë këtë.”

<sup>7</sup> Shiko raportin 03/2006 të shtyllës së III-të (OSBE) mbi monitorimin e Kuvendit të Kosovës.

<sup>8</sup> “Në çdo seancë plenare të Kuvendit, deputetit i jipet e drejta të propozojë [mocion procedural] për të . . . konstatuar se a është shkelur Rregullorja e punës.”

deri në dy minuta sipas rregullës 22.7. Z. Hyseni gjithashtu bëri vërejtje në faktin që nuk ishte vënë në votim propozimi i z. Xhemajli për ndërprerjen e seancës. Kryesuesi u përgjigj që nuk e kishte caktuar ai kohëzgjatjen, por që parashihej me rregullat procedurale të miratuara nga Kuvendi. Kryesuesi nuk bëri koment në pohimin se është dashur të vëhet në votim propozimi i z. Xhemajli.

Më 23 qershor, z. Xhemajli i dorëzoi një mocion Komisionit për çështje gjyqësore, legislative dhe Kornizë Kushtetuese duke pohuar se ishin shkelur të drejtat e tij të parapara me rregullat 30.1(b) dhe 30.2, sepse i është lejuar vetëm një minutë kohë për të folur dhe propozimi i tij nuk është vënë në votim.<sup>9</sup>

*Rregullat 30.1(b) dhe 30.2 parashohin që “në çdo seancë plenare të Kuvendit, deputetit i jepet e drejta të propozojë (mocion procedural) për . . . shtyrë seancën . . . Për mocionin për ta shtyrë seancën menjëherë mbahet votim, pa debat.”*

*Rregulla 22.7 parasheh që “nëse Kuvendi nuk vendos ndryshe, diskutimi në Kuvend nuk zgjat më shumë se dhjetë (10) minuta për secilin deputet. Diskutimi lidhur me rendin e ditës nuk zgjat më shumë se dy (2) minuta.” Propozimi i z. Xhemajli për ta ndërprerë seancën nuk ishte diskutim lidhur me rendin e ditës, por mocion procedural siç definohet në rregullat 30.1(b) dhe 30.2. Rregullorja e punës nuk e rregullon shprehimisht kohëzgjatjen e diskutimit lidhur me mocionet procedurale. Diskutimi i z. Xhemajli është ndërprerë pas një minute kohe, duke u bazuar në supozimin e gabuar se po bisedonte lidhur me rendin e ditës, dhe me pohimin e gabuar se diskutimet lidhur me rendin e ditës zgjasin vetëm një minutë. Rregulla 30.2 parasheh që propozimi i z. Xhemajli për ndërprerjen e seancës është dashur të vëhet “menjëherë në votim, pa debat.”*

### Shpërndarja e dokumentave

- Projektligji për ndryshimin e ligjit 2003/7 mbi arkivat dhe materialin arkivor dhe projektligji për mbrojtjen dhe nxitjen e të ushqyerit me qumësht gjiri ishin shpërndarë më 28 prill; projektligji për dhe projektligji për kërkimet gjeologjike ishte shpërndarë më 3 maj. Andaj, projektligjet janë shpërndarë 22 përkatësisht 20 ditë pune para shqyrtimit të tyre të parë në seancën plenare më 1-2 qershor 2006. Projektligji për ndryshimin e ligjit 2004/12 për standardizim ishte shpërndarë më 11 maj, dhe projektligji për raportimin financiar të ndërmarrjeve ishte shpërndarë më 16 maj. Andaj, projektligjet janë shpërndarë 28 përkatësisht 21 ditë pune para shqyrtimit të tyre të parë të caktuar për seancën plenare të 15 qershorit. Projektligji për peshkatari dhe akuakulturë ishte shpërndarë më 30 maj dhe projektligji për prokurimin publik ishte shpërndarë më 8 qershor. Andaj, projektligjet janë shpërndarë 21 përkatësisht 14 ditë pune para shqyrtimit të tyre të parë të caktuar për seancën plenare të 29 qershorit.

*Rregulla 35.1, parasheh që shqyrtimi i parë i projektligjtit të bëhet jo më parë se dhjetë ditë pune dhe as më shumë se tri javë pune nga dita e shpërndarjes së tij. Shumica e projektligjeve gjatë kësaj periudhe raportuese janë shqyrtuar për të parën herë pas më shumë se tri javësh që nga data e shpërndarjes së tyre. Kuvendi edhe më tej vazhdon të ketë disa vështirësi në shqyrtimin e projektligjeve në pajtim me afatin e përcaktuar në rregulloren e punës edhe përkundër faktit se ka filluar t'i mbajë seancat plenare më shpesh.*

### Procesi i votimit

- Gjatë shqyrtimit të dytë të projektligjtit kundër shpifjes dhe fyerjes në seancën plenare të 15 qershorit, z. Nazim Jashari (ORA) vërejtë se numri i përgjithshëm i votave të lajmëruara për amandamentet ishte vetëm 57 dhe kërkoi nga Kryesuesi që të konfirmonte nëse ekzistonte kuorumi. Kryesuesi konstatoi se 62 deputetë ishin të pranishëm, por që disa prej tyre po abstenonin dhe se “kishin të drejtë ta bëjnë”. Më vonë gjatë seancës së njëjtë, derisa Kuvendi e votonte në shqyrtim të parë projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për standardizimin, z. Jashari theksoi se nuk kishte kuorum gjatë votimit. Kryetari i Kuvendit kërkoi

<sup>9</sup> Shqyrtimi i mocionit të z. Xhemajli nga ana e Komisionit bie jashtë kësaj periudhe raportuese, andaj do të mbulohet nga raporti i ardhshëm monitories.

nga punonjësit e administratës t'i numërojnë deputetët e pranishëm në sallë, dhe pasi u vërtetua se vetëm 60 deputetë ishin të pranishëm, e shpalli të pavlefshëm votimin e projektligjit në shqyrtimin e parë dhe i thirri deputetët të kthehen në sallë. Me të siguruar kuorumin, ai e vëri projektligjin edhe njëherë në votim dhe i njëjti është miratuar me 58 vota për dhe pa vota kundër.<sup>10</sup> Në seancën plenare të 29 qershorit, Kryetari i Kuvendit konstatoi se nuk kishte kuorum kur ishte koha për ta votuar raportin vjetor 2005 të KRPP, prandaj i thirri deputetët të kthehen në sallë. Pasi u kthyen disa deputetë, ai njoftoi se 64 deputetë ishin të pranishëm dhe e vëri raportin në votim. Kishte kuorum për të gjitha votimet e tjera në seancat plenare në fjalë.  
*Kjo është në pajtim me nenin 9.1.32 të Kornizës Kushtetuese dhe rregullën 31.1, e cila parasheh që për marrjen e vendimeve duhet të jenë të pranishëm shumica e deputetëve.*

- Gjatë shqyrtimit të dytë të projektligjit për operën, baletin dhe filarmoninë e Kosovës, pasi shumica e deputetëve të pranishëm kishin votuar në favor të shtatë amendamenteve të para nga lista e gjatë e amendamenteve, z. Sabri Hamiti (LDK) propozoi që pjesa e mbetur e amendamenteve të votohen *en bloc*, duke deklaruar se rregullorja e lejon një mënyrë të tillë të votimit “nëse nuk ka vërejtje nga komisioni.” Kryetari i Kuvendit u përgjigj duke thënë se ai pajtohej me z. Hamiti, por rregullorja nuk lejonte një mënyrë të tillë votimi. Z. Jakup Krasniqi (PDK) deklaroi se megjithatë, Kuvendi e ka të drejtën për të përdorur procedurë tjetër votimi nëse arrin marrëveshje për vepruar në atë mënyrë. Kryetari i Kuvendit deklaroi se bazuar në këto dy propozime ai do ta ftonte Kuvendin të votojë që pjesa e mbetur e amendamenteve të propozuara në projektligjin në fjalë të votoheshin *en bloc*. Dyzet e shtatë deputetë votuan në favor të kësaj procedure, katër votuan kundër, dhe grupi parlamentar ORA doli jashtë nga salla plenare, duke deklaruar se procedura e propozuar është shkelje e rregullores. Pjesa e mbetur e amendamenteve ishte votuar *en bloc* me shumicë votash për.

Gjatë shqyrtimit të dytë të projektligjit për mbrojtjen kundër fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera, shefat e grupeve parlamentare të LDK-së, PDK-së dhe AAK-së deklaruan se grupet e tyre nuk kishin vërejtje në asnjërin prej amendamenteve. Kryetari i Kuvendit deklaroi se Kuvendi do t'i votonte amendamentet. Amendamentet janë miratuar me shumicë votash për.

*Rregulla 37.2 parasheh që “Amendamentet shqyrtohen veç e veç sipas radhës që paraqiten në tekstin e projektligjit, përveç nëse ndonjë grup i amendamenteve ka ndikim veprues në nenet e tjera. Në këtë rast ata mund të shqyrtohen aty ku paraqiten së pari në tekst dhe mund t'i nënshtrohen një votimi të vetëm. Kryetari i Kuvendit vendos kur gjen zbatim kjo. Komisioni Funkcional, gjithashtu, përcakton radhën sipas së cilës do të shqyrtohen amendamentet sipas natyrës përmbajtësore të tyre kur paraqiten në të njëjtin vend në tekst.” Argumenti që ishte dhënë gjatë shqyrtimit të dytë të të dy ligjeve nuk ishte se amendamentet kanë ndikim në njëra-tjetrën, por se nuk kishte vërejtje të dukshme brenda Kuvendit në asnjërin prej amendamenteve. Andaj, rregulla 37.2 nuk përmban ndonjë dispozitë për votimin e amendamenteve en bloc në rastet si ai i projektligjit për operën, baletin dhe filharmoninë e Kosovës apo projektligjin për mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera.*

*Rregulla 61 parasheh se “për shmangiet nga Rregullorja e punës mund të vendos Kuvendi me dy të tretat e shumicës së deputetëve të pranishëm në Kuvend, përveç nëse kjo është në kundërshtim me dispozitat e Kornizës Kushtetuese.” Vendimi për t'i votuar amendamentet en bloc nuk do ta kishte shkelur asnjë dispozitë të Kornizës Kushtetuese, andaj ka mundur të merret nga Kuvendi në pajtim me rregullën 61, duke pasur parasysh se propozimi ka marrë mbështetjen e dy të tretave të deputetëve të pranishëm. Në rastet e ardhshme, kur Kuvendi dëshiron t'i shmanget përkohësisht rregullores së punës, propozimet e tilla duhet të trajtohen në kontekst të rregullës 61.*

#### Emërimi i zëvendësministrave

- Më 1 qershor, kur Kuvendi erdhi te pika e rendit të ditës “miratimi i emërimit të z. Altay Suroy për zëvendësministër të drejtësisë”, z. Dzezair Murati (6+/Vakat) kërkoi që kjo pikë të shtyhet

<sup>10</sup> Siç ka cekur kryesuesi më herët në seancë, deputetët shpesh përmbahen nga votimi dhe për atë arsye numri i përgjithshëm i votave është ndonjëherë më i vogël se 61, përkundër prezencës së kuorumit.

për ditën e nesërme sepse numri i deputetëve të pranishëm në atë kohë nuk ishte i “mjaftueshëm”, duke shtuar se ai kishte arritur marrëveshjen për shtyerjen me disa nga shefat e grupeve parlamentare. Kryesuesi u përgjigj se të pranishëm ishin 79 deputetë, duke mos u pajtuar me pohimin se nuk kishte mjaft deputetë të pranishëm për të vazhduar me pikën e rendit të ditës, por ai deklaroi se i takon Kuvendit të vendos për ta shtyrë këtë pikë apo jo. Z. Jakup Krasniqi (PDK) propozoi që kjo pikë të heqej nga rendi i ditës duke debatuar se zëvendësministrat nuk votohen nga Kuvendi dhe se emërimi i tyre është çështje e brendshme e Qeverisë. Z. Alush Gashi (LDK) dhe znj. Gjylnaze Sylja (AAK) u pajtuan në emër të grupeve të tyre parlamentare që kjo pikë të shtyhej për ditën tjetër. Kryeministri, i cili ishte i pranishëm në seancë gjatë asaj kohe, i bëri me dije kryesuesit se ai pajtohej me propozimin e z. Krasniqi që emërimi i zëvendësministrave mos t’i nënshtrohej votimit në Kuvend. Seanca vazhdoi ditën e nesërme ku Kryesuesi deklaroi se kishte pranuar në ndërkohë shumë komente lidhur me emërimin e zëvendësministrave. Kryesuesi theksoi se rregullorja e Kuvendit dhe rregullorja përkatëse e UNMIK-ut parashohin që zëvendësministrat të votohen nga Kuvendi, por e përsëriti besimin e tij se emërimi i tyre duhej të ishte çështje e brendshme e Qeverisë dhe i pyeti shefat e grupeve parlamentare për opinionin e tyre. Z. Alush Gashi (LDK) deklaroi se Kuvendi tashmë e kishte vënë praktikën e votimit të zëvendësministrave por ai personalisht nuk ishte i sigurt se cila ishte mënyra më e duhur/përshtatshme për miratimin e tyre. Ai shtoi se propozimin e PDK-së për t’ia kaluar emërimin e zëvendësministrave krejtësisht Qeverisë e konsideronte shumë konstruktiv por sugjeroi se duhet të bëhen konsultime me PSSP-në lidhur me procedurën e duhur. Ai vazhdoi se nëse PSSP-ja nuk pajtohej me propozimin, Kuvendi duhet ta votojë kandidatin në seancën e radhës. Znj. Gjylnaze Sylja (AAK) deklaroi se grupi i saj parlamentar e mbështeste propozimin z. Gashi për t’u konsultuar me PSSP-në për këtë çështje. Z. Naim Maloku (AAK) deklaroi se ai kishte qenë i përfshirë në hartimin e rregullores për ministrinë e punëve të brendshme dhe e inkurajoi Kuvendin që formalisht të votonte për emërimin e zëvendësministrit. Znj. Teuta Sahatqija (ORA) e citoi rregullën 18.3 (shiko paragrafin më poshtë) duke deklaruar se Kuvendi duhej t’i përmbahet rregullores së punës duke votuar për kandidatin, përndryshe rregullorja duhet të amendamentohet nëse deputetët nuk pajtohen me dispozitën në fjalë. Z. Gjergj Dedaj (Grupi për Integrim) deklaroi se Kuvendi i kishte votuar zëvendësministrat në të kaluarën andaj nuk duhej ta ndryshonte praktikën e tij. Z. Nazim Jashari e përsëriti deklaratën e z. Sahatqija dhe arsyetoi se koalicioni qeverisës nuk donte të votonte për kandidatin atë ditë meqë sipas të gjitha gjasave nuk do t’i merrte 61 votat e duhura për t’u miratuar, por komentoi se çdo propozim për shtyerjen e ndonjë pike të rendit të ditës duhet të hudhet në votim. Kryesuesi, i bazuar në deklaratat që ishin bërë, konkludoi se kjo pikë duhet të shtyhet për seancën e radhës dhe insistoi që nuk kishte nevojë për ta hudhur në votim shtyerjen sepse koalicioni qeverisës i cili e kishte propozuar kandidatin, e kishte tërhequr propozimin për atë ditë. Përveç kundërshtimeve të ORA-s, nuk pati kundërshtime të mëtutjeshme ndaj shtyerjes së kësaj pike të rendit të ditës.

*Rregulla 18.3 parasheh se “Qeveria e Kosovës, e përbërë nga kandidatët për kryeministër, zëvendëskryeministër dhe nga kandidatët për ministra dhe për zëvendësministra, konsiderohet e zgjedhur nëse kandidatët marrin shumicën e votave të deputetëve të Kuvendit. Mënyrën e votimit për zgjedhjen e Qeverisë e përcakton Kuvendi.” Neni 1.2.1 i rregullores së UNMIK-ut 2005/15 për ndryshimin e rregullores së UNMIK-ut 2001/19 parasheh se “zëvendëskryeministri dhe zëvendësministrat emërohen nga Kryeministri pas miratimit të kandidatit në fjalë nga Kuvendi i Kosovës.” Zgjedhja e ministrave është e rregulluar nga neni 9.3.8 i Kornizës Kushtetuese, i cili parasheh se “pas zgjedhjeve, ose në rast se Kryeministri jep dorëheqjen apo nëse vendi i tij mbetet i lirë për arsye të tjera . . . Kryeministri bashkë me ministrat zgjidhen nga shumica e deputetëve të Kuvendit”. Korniza Kushtetuese nuk përmban ndonjë dispozitë që në mënyrë të qartë e rregullon rolin e Kuvendit në emërimin individual të Ministrave ose zëvendësministrave<sup>11</sup>. Më 26 qershor, Kryesia i ka dërguar një kërkesë zyrës ligjore të UNMIK-*

<sup>11</sup> Posti i zëvendësministrit nuk ka ekzistuar në IPVQ në kohën kur është bërë hartimi i Kornizës Kushtetuese.



*ut për interpretim ligjor të rregulloreve përkatëse të UNMIK-ut lidhur me emërimin e zëvendësministrave.*<sup>12</sup>

### Interpelanca

- Në seancën e 15 qershorit, Kryetari i Kuvendit u përkujtoi deputetëve se, sipas dispozitave të amendamentuara të Rregullores në seancën e mëparshme plenare, grupi parlamentar që e ka propozuar interpelancën kishte të drejtë ta hapte debatin me një deklaratë prej dhjetë minutave dhe ta përmbyllte debatin me një deklaratë prej pesë minutave, ndërsa kohëzgjatja e pjesës tjetër të debatit do të reflektonte përfaqësimin në Kuvend të secilit grup parlamentar. Z. Jakup Krasniqi (PDK) e hapi debatin e interpelancës duke pohuar se ndryshimet që i ishin bërë Ligjit për të drejtat dhe statusin e familjeve të dëshmorëve, invalidëve, veteranëve dhe pjesëtarëve të UÇK-së, dhe viktimave civile të luftës, pas miratimit të tij, paraqisnin keqpërdorim të kompetencave nga ana e PSSP-së dhe Kryeministrit, i cili “ka për detyrë ta zbatojë ligjin, e jo ta nënshkruajë atë.” Kryeministri pohoi se e kishte sqaruar plotësisht këtë çështje për shtypin dhe në një letër për Kryesinë e Kuvendit, dhe se do ta sqaronte edhe para Kuvendit, për hir të respektimit të parimit të transparencës. Kryeministri pohoi se ishte ideja e PSSP-së që ai ta nënshkruante ligjin, vetëm si *gest simbolik*, për shkak të rëndësisë së ligjit. Ai theksoi se për ndryshimet në ligj ishte informuar tek pas nënshkrimit të ligjit, dhe se menjëherë kishte kërkuar sqarim nga PSSP-ja. Ai shtoi se kjo çështje po shqyrtohej nga Zyra Ligjore e KB-së në New York, dhe se ai e pranonte ligjin vetëm në formën me të cilën është miratuar nga Kuvendi. Disa deputetë nga grupet e ndryshme parlamentare kanë bërë deklaratat para se të përmbyllet debati nga z. Krasniqi.

Në fund të seancës plenare të 29 qershorit, z. Naser Osmani (LDK) e prezantoi interpelancën e tij lidhur me mihjen e jashtëligjshme të zhavorit. Ministri për Mjedis dhe Planifikim Hapësinor Ardian Gjini (AAK) dha përgjigje në interpelancë, pas së cilës pasuan deklaratat e disa deputetëve nga grupet e ndryshme parlamentare dhe përgjigja e fundit e Ministrit Gjini. Z. Osmani kërkonte fjalën për ta përmbyllur debatin, por Kryesuesi vazhdoi me pikën tjetër të rendit të ditës pa ia dhënë fjalën z. Osmani. Z. Osmani nuk u përpoq më tej ta marrë fjalën.

*Sipas rregullës së re 25.7, grupi parlamentar që ka propozuar debatin për interpelancë “ka të drejtë ta mbyll debatin me një kohë që nuk i kalon pesë (5) minuta”. Sipas kësaj, z. Osmani është dashur automatikisht t’i jipet fjala në fund të debatit për interpelancën më 29 qershor.*

### Pyetjet për Qeverinë

- Pas interpelancës në seancën plenare të 15 qershorit, Kryetari u përkujtoi deputetëve se, sipas dispozitave të amendamentuara të Rregullores në seancën e mëparshme plenare, deri në 50 minuta të secilës seancë plenare duhet t’u dedikohen pyetjeve të deputetëve për Qeverinë, me një minute për pyetjen e deputetit, tre minuta për përgjigjen e Ministrit, një minutë për pyetjen shtesë dhe dy minuta për përgjigjen në pyetjen shtesë. Vetëm dy nga shtatë pyetjet e parapara për seancën e 15 qershorit kanë marrë përgjigje; pesë pyetjet tjera nuk kanë marrë përgjigje për shkak të mospranisë së ministrave përkatës. Z. Alush Gashi i thirri, në emër të LDK-së, të gjithë ministrat që të jenë të pranishëm në seancën e radhës për t’u përgjigjur në pyetjet që i kishin marrë, duke përkujtuar se koalicioni qeverisës kishte vendosur të bëhet “shumicë e përgjegjshme”. Z. Sabri Hamiti (LDK) theksoi se ishte hera e parë që po zbatohet rregulla e re dhe se mund të ekzistonte nevoja për sqarim të mëtejshëm të procedurës. Në seancën plenare të 29 qershorit, ministrat janë përgjigjur në dhjetë nga 14 pyetjet. Në secilin rast kur pyetja nuk merrte përgjigje, Kryetari i Kuvendit e informonte Kuvendin se pyetja do të përsëritej në seancën e ardhshme plenare. Z. Emrush Xhemajli (LPK) e ka bërë një pyetje për Qeverinë në seancën e 29 qershorit, por nuk e kishte dorëzuar me shkrim para seancës. Kryetari i Kuvendit u përgjigj se Ministri mund të përgjigjej aty për aty nëse ishte i përgatitur, sepse pyetja përndryshe

<sup>12</sup> Zyra Ligjore e UNMIK-ut i a ka dërguar Kryetarit të Kuvendit interpretimin ligjor të kërkuar më 5 korrik, që bie jashtë periudhës raportuese në fjalë andaj do të përfshihet në raportin e ardhshëm mbi monitorimin e Kuvendit të Kosovës.

duhet të shtyhej për seancën e radhës. Z. Xhemajli nuk mori përgjigje në pyetjen e tij në seancën në fjalë.

*Periudha e pyetjeve është kryer në pajtim me rregullën e re 26, mbi “Pyetjet për Qeverinë për përgjigje me gojë”. Pyetja e z. Xhemajli, të cilën e ka bërë vetëm gojarisht në seancën e 29 qershorit, duhet sidoqoftë të dorëzohet me shkrim në Zyrën për Parashpresa, të paktën 48 orë para seancës së ardhshme plenare në mënyrë që ta marrë përgjigjen.*

#### 4. Qasja dhe pjesëmarrja e barabartë e komuniteteve

##### Emërimi i anëtarëve të ri të komisioneve

- Kryesia, në takimin e saj më 25 maj edhe një herë e shqyrtoi kërkesën e Grupit për Integrim për t’u përfshirë në komisionet e Kuvendit.<sup>13</sup> Pas shumë diskutimeve se si të përmbushet kërkesa “pa e prishur balancin politik” në komisione, Kryesia përfundimisht u pajtua që ta marrë në shqyrtim një kërkesë të ORË-s për rritjen e numrit të anëtarëve në secilin komision prej dymbëdhjetë në 14, duke u përcaktuar se megjithatë duhet konsultuar edhe shefat e grupeve parlamentare lidhur me këtë propozim. Në takimin konsultativ të Kryesisë me shefat e grupeve parlamentare më 29 maj, znj. Teuta Sahatqija e paraqiti propozimin në emër të ORA-s. Pas një diskutimi të mjaftueshëm anëtarët e Kryesisë dhe shefat e grupeve parlamentare u pajtuan lidhur me propozimin, më saktësisht, se një anëtar nga opozita dhe një anëtar nga koalicioni qeverisës do t’i shtohen secilit nga tetë komisionet funksionale. Shpërndarja e saktë e vendeve ishte bërë si vijon: gjashtë për Grupin për Integrim, dy PDK-së, pesë LDK-së, dhe tri AAK-së.<sup>14</sup> Z. Gjergj Dedaj e kundërshtoi propozimin në emër të Grupit për Integrim duke insistuar se grupi i tij parlamentar duhet të përfaqësohet në të gjitha komisionet funksionale. Z. Naim Maloku (AAK) propozoi që LDK-ja mund t’i merrte të tetë vendet që i ishin shpërndarë koalicionit qeverisës me arsyetimin se AAK-ja tashmë ishte e përfaqësuar në masë të mjaftueshme nëpër komisione.<sup>15</sup> Në seancën plenare të 1-2 qershorit, Kryesuesi, gjatë paraqitjes së propozimit para Kuvendit, deklaroi se PDK-ja ishte e gatshme të bënte sakrificë duke marrë vetëm dy vende në komisione në mënyrë që të arrihej marrëveshja për përfshirjen e Grupit për Integrim, “edhe pse tashmë është e përfaqësuar në pesë komisione”. Z. Dedaj u përgjigj se deri më tani grupi i tij kishte qenë i përfaqësuar vetëm në komisionin për të drejtat dhe interesat e komuniteteve, dhe ai deklaroi se për të ishte e pakuptueshme që ishin dashur gjashtë muaj që grupi i tij parlamentar të përfshihej në komisionet funksionale. Z. Dedaj theksoi se Grupi për Integrim do të vazhdojë të insistoj për t’u anëtarësuar në të gjitha komisionet funksionale, por ata do ta pranonin propozimin aktual nën diskutim si hap të parë drejtë përfshirjes më të gjërë. Propozimi është miratuar me 68 vota për dhe gjashtë vota kundër. Kryesia, në takimin e saj më 12 qershor e shqyrtoi kërkesën e Grupit për Integrim që anëtarët e ri të komisioneve, të propozuar të miratohen formalisht nga Kuvendi. Drejtori i departamentit për mbështetje ligjore dhe procedurale shpjegoi se deri më atë ditë vetëm propozimi për zgjerimin e komisioneve ishte miratuar; emrat e anëtarëve të ri të komisioneve mbeten t’i nënshtrohen votimit. Pas një diskutimi të shkurtër Kryesia konkludoi se anëtarët e Grupit për Integrim do të miratohen së bashku me emrat e anëtarëve të ri nga LDK-ja dhe PDK-ja, të cilat ende nuk ishin dorëzuar. Një diskutim i ngjashëm pasoi edhe në mbledhjen e Kryesisë të mbajtur më 26 qershor, ku është vendosur që të gjithë anëtarët e ri të komisioneve të votohen në seancën plenare më 29 qershor nëse LDK-ja dhe PDK-ja do t’i dorëzonin propozimet e tyre me kohë. Të gjithë emrat e propozuar të anëtarëve të ri janë dorëzuar para seancës plenare më 29 qershor, kështu që kjo pikë është përfshirë në rendin e ditës.

<sup>13</sup> Grupi për Integrim së pari e ka paraqitur këtë kërkesë para disa muajve. Shiko raportin 02/2006 të shtyllës së III-të (OSBE) mbi monitorimin e Kuvendit të Kosovës.

<sup>14</sup> Shpërndarja ashtu siç është në radhitje – gjashtë GpI, dy PDK, pesë LDK, dhe tri AAK – nuk është në proporcion me përfaqësimin e tyre në Kuvend si tërësi, por ka për qëllim rregullimin e mospërputhjeve të mëparshme në përfaqësimin e grupeve parlamentare nëpër komisione.

<sup>15</sup> Z. Maloku foli në emër të AAK-së sepse shefja e grupit parlamentar znj. Gjylnaze Sylja nuk kishte mundur të merrte pjesë në mbledhje.

Kah fillimi i seancës, z. Alush Gashi dhe z. Jakup Krasniqi i paraqitën emrat e anëtarëve të rië të komisioneve të propozuar nga LDK-ja, përkatësisht PDK-ja.<sup>16</sup> Znj. Teuta Sahatqija (ORA) pohoi se grupi i saj parlamentar i përkrahte propozimet e LDK-së, ngase është e drejtë e secilit grup parlamentar që t'i propozojë anëtarët e vetë në komisione, por tërhoqi vërejtjen në nominimin e z. Behxhet Brajshori (LDK), duke u thirrur në rregullën 42.1 sipas së cilës ministrave u ndalohet të jenë anëtarë të komisioneve, dhe konstatoi se parimi i njëjtë duhet të vlejë edhe për zëvendësministrat. Ishte e paraparë që propozimet të vëhen në votim tek në fund të seancës plenare, kështuqë nuk u bënë më diskutime në atë moment. Më vonë, derisa Kuvendi po përgatitej për votimin e propozimeve, z. Gashi deklaroi se LDK-ja kishte vendosur ta propozonte z. Ilmi Ahmeti në vend të z. Brajshori meqë emërimi i tij në komision mund të konsiderohej konflikt interesi. Z. Ferid Agani (Grupi për Integrim) komentoi se kishte marrur shumë kohë që grupi i tij të përfshihej në komisionet funksionale, por se ishte i lumtur që më në fund e kishin fituar anëtarësinë në komisione. Emërimet e reja në komisione të LDK-së, PDK-së dhe Grupit për Integrim u miratuan.

*Siç është cekur më herët në këtë raport dhe në raportet e mëparshme, Grupi për Integrim fillimisht e ka dorëzuar kërkesën për përfshirje në komisionet funksionale disa muaj më parë. Kërkesa është miratuar tek pas disa muaj diskutimesh në seanca plenare dhe mbledhjet e Kryesisë dhe pas dy kërkesave tjera më shkrim të Grupit për Integrim. Madje edhe pas miratimit nga Kuvendi të propozimit për zgjerimin e komisioneve me qëllim të përfshirjes së anëtarëve të Grupit për Integrim “pa e prishur balancin politik”, miratimi i anëtarëve të ri të Grupit për Integrim në gjashtë komisione ishte shtyrë për katër javë tjera, apo dy seanca plenare, me arsyetimin se të gjithë anëtarët e ri në komisione (Grupi për Integrim, LDK dhe PDK) duhej të miratoheshin në të njëjtën kohë. Miratimi formal i anëtarëve të komisioneve bëhet me një votim të shpejtë; Kuvendi ka mundur t'i miratojë menjëherë anëtarët e Grupit për Integrim në vend se ta vonojë pjesëmarrjen e tyre në komisione për disa javë më tepër duke pritur propozimet e LDK-së dhe PDK-së.*

*Ndërhyrja e znj. Sahatqija në seancën e 29 qershorit dhe vendimi pasues i LDK-së për ta zëvendësuar z. Brajshori me z. Ahmeti, si anëtar i ri i komisionit, ishte në pajtim me parimin e ndarjes së pushteteve të paraparë në rregullën 42.1, sipas së cilës “Ministri nuk mund të jetë anëtar komisioni.” Në pajtim me këtë parim, Kuvendi do të mund t'i amandamentonte rregullat e procedurës për ta zgjeruar ndalesën e anëtarësisë në komisione edhe për zëvendësministrat.*

## 5. Qasja

Gjatë periudhës raportuese, Shtylla e III-të (OSBE) ka pasur qasje në seancat plenare, në mbledhjet e rregullta të Kryesisë, si dhe në të gjitha komisionet. Shtylla e III-të (OSBE) gjithashtu ka pranuar kopjet e dokumentave të shqyrtuara nga Kuvendi si dhe transkriptin e seancave të kaluara.

## 6. Transparenca

Radio Televizioni i Kosovës (RTK) ka siguruar transmetimin e drejtpërdrejtë të seancave plenare në fjalë. Publikut dhe monitoruesve institucional iu është mundësuar hyrja në seancat plenare. Kuvendi ka web faqen ([www.kuvendikosoves.org](http://www.kuvendikosoves.org), [www.skupstinakosova.org](http://www.skupstinakosova.org), [www.assemblyofkosovo.org](http://www.assemblyofkosovo.org)). që përmban detaje biografike të deputetëve të Kuvendit, informacione për strukturën dhe funksionimin e Kuvendit, kopje të ligjeve dhe rezolutave të miratuara nga Kuvendi, si dhe informacione të tjera në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze.

FUND.

---

<sup>16</sup> Emrat e Grupit për Integrim nuk janë prezentuar në fillim të seancës, ngase ata ishin dorëzuar shumë më herët.